



INITIATIVE FOR AGRICULTURAL DEVELOPMENT OF KOSOVO
INICIATIVA PËR ZHVILLIMIN E BUJQËSISË SË KOSOVËS
INICIATIVA ZA POLJOPRIVREDNI RAZVOJ KOSOVA

RAPORTI VJETOR 2018



Të jetojmë nga toka dhe puna jonë

Të nderuar lexues,

Në dorë keni raportin vjetor të IADK-së të vitit 2018, të përshkruar për të arriturat, projektet, donatorët, aktivitetet, partnerët, përfituesit, shtrirjen gjeografikë dhe mbështetjen që IADK ka dhënë në sektorin e bujqësisë dhe zhvillimit rural.



Viti 2018 është ndër vitet më të suksesshme të IADK-së sepse kishim me shumë donatorë/partner, projekte, përfitues, përkrahje, sektor të rinj, grupe të reja, prodhim, punësim dhe trajnime profesionale. Arritjet e organizatës si liderë në zhvillimin e bujqësisë dhe zhvillimit rural në Kosovë, në zbatimin e projekteve, kryerjen e shërbimeve ndaj palëve, krijimin e partneritetit të qëndrueshëm me partneret tanë gjatë vitit 2018 tregojnë një zhvillim të qëndrueshëm dhe një bazë të shëndetshme për zhvillime të mëtejshme të bujqësisë në vitet në vazhdim.

Fokus kryesor i IADK-së në vitin 2018 ka qenë: ngritja profesionale e të rinjve, punësimi i të rinjve, krijimi i kushteve më të favorshme socialo-ekonomike, krijimi i një ambienti më të volitshëm për punë dhe jetë në Kosovë, këto janë arritur me trajnime profesionale, praktika në pune, vizita studimore dhe dhënia e granteve.


IADK suksesshëm ka përfunduar strategjinë e saj 5 vjeçare 2012-2018 dhe është në proces të fillimit të strategjisë së re 5-10 vjeçare e cila do të finalizohet në pjesën e parë të vitit 2019.

Edhe ky vit u karakterizua si një vit jo i lehtë për sektorin e bujqësisë në Kosovë, megjithatë, gjatë këtij viti, sektori i pemëtarisë ka pasur një rritje të lehtë të prodhimeve por çmime e tyre kanë qenë shumë të ulëta sidomos të: mjedrës, mollës, dredhëzës kjo ka ndikuar që shumë fermerë janë zhgënjyer dhe janë demotivuar, situatë e njëjtë ishte edhe me drithërat deri sa misri ka arritur maksimumin e prodhimtarisë. Sektori i perimeve ka pasur në përgjithësi dështime si pasojë e reshjeve, sëmundje dhe dëmtuesve por çmimet e perimeve atyre që janë kultivuar në ambiente të mbyllura kanë qenë stabile dhe të larta gjatë tërë vitit. Sektori i qumështi është duke u ballafaquar me sfidat e njëjta sikurse vitet tjera.

Edhe më tutje njëra ndër sfidat kryesore të bujqësisë në Kosovë mbetet zbatimi i ligjeve, zbatimi dhe ndryshimet e strategjisë nga ministria e bujqësisë dhe komunat, të gjitha këto kanë krijuar një konfuzitet tek fermerët dhe partneret.

Si Drejtor Ekzekutiv, do të doja të falënderoja sinqerisht të gjithë ata që ndër vite kanë bërë të mundur suksesin e organizatës së IADK-së, Bordit të Drejtorëve, punonjësit tanë, fermerët dhe partnerët vendorë dhe ndërkombëtarë për bashkëpunimin dhe mbështetjen e pakursyer të tyre në rrugëtimin e përbashkët.

Sinqerisht,



Përmbajtja

Fjala hyrëse e drejtorit të IADK-së.....	3
TË ARRITURAT NË VITIN 2018.....	5
PARTNERËT DHE DONATORËT E IADK-së GJATË VITIT 2018.....	6
1. MUNDËSIMI I VETËPUNËSIMIT TË RINISË DHE GRUPEVE TË MARGJINALIZUARA NË VISET RURALE TË KOSOVËS.....	6
GRANTET PËRKRAHËSE PËR FERMERËT DHE GRATË NË BIZNES.....	6
1.1 Ngritja e serrave me sipërfaqe prej 160 m ²	7
1.2 Ngritja e pemishteve me arra me sipërfaqe prej 0.50 -0.80 ha.....	7
1.3 Ngritja e plantacioneve me bimë mjekësore.....	7
1.4 Laktofrizat për deponim dhe ruajtje të qumështit.....	8
1.5 Trajnimi profesional i grupit të fermerëve në blegtori.....	9
1.6 Investimet në sektorin e bletarisë -pajisje.....	9
1.7 Ngritja e njësive për përgatitjen e ëmbëlsirave.....	10
1.8 Investimet në bufen e shkollës.....	10
1.9 Ngritja e njësive për përpunimin e pemëve dhe perimeve.....	11
1.10 Investime në përmirësim të infrastrukturës së objektit.....	11
1.11 Përkrahja e studentëve në punë praktike.....	12
1.12 Panaiet.....	12
2. PËRKRAHJA E FERMERËVE TË VEGJËL ME PAJISJE DHE PROMOVIMI I ENERGJISË SË RIPËRTËRITSHME.....	12
2.1 Ngritja e serrave me sipërfaqe prej 200 m ²	13
2.2 Investimet në sektorin e bletarisë - pajisje.....	14
2.3 Laktofriza për ruajtje të qumështit.....	14
2.4 Mekanizëm/pajisje bujqësore.....	14
2.5 Ngritja e njësive për përgatitjen të ëmbëlsirave.....	15
2.6 Ngritja e pikave përpunuese për pemë dhe perime.....	15
3. MBËSHTETJA E FUQIZIMIT EKONOMIK TË FERMERËVE TË VEGJËL NË KOMUNAT VERIORE TË RAJONIT TË MITROVICËS.....	15
4. MBËSHTETJA E ZINXHIMIT TË VLERAVE TË BMA PËRMES KRIJIMIT TË PUNËSIMIT DHE VAZHDIMIT TË EKSPORTIT.....	16
4.1 Grantet përkrahëse për ngritje të plantacioneve me bimë mjekësore dhe aromatike.....	16
5. PËRFSHIRJA EKONOMIKE E TË RIATDHESUARVE PËRMES BUJQËSISË NË ZONAT RURALE DHE NGRITJA E KAPACITETEVE PËRMES TRAJNIMEVE PROFESIONALE.....	18
6. NGRITJA E KAPACITETEVE PROFESIONALE TË TË RINJËVE NË SEKTORIN E BUJQËSISË.....	19
6.1 Trajnimi i të rinjve në sektorin e bujqësisë/përpunimit.....	19
6.2 Përkrahje e studentëve në punë praktike.....	20
7. PROMOVIMI I MSA DHE RËNDËSISË SË EKSPORTIT TË PRODUKTEVE BUJQËSORE.....	21
7.1 Sesionet informuese.....	21
7.2 Hulimtim i përfituesëve potencial të MSA.....	21
7.3 Trajnimet.....	21
7.4 Vizitë studimore.....	21
7.5 Punëtoritë.....	22
7.6 Konferenca.....	22
7.8 Video reportazh.....	22
8. MONITORIMI I PROCESIT TË KONSULTIMEVE PUBLIKE NË NIVEL TË QEVERISË 2018.....	22
9. MBËSHTETJA E NDËRMARRËSISË SHOQËRORE DHE PROMOVIMI I FUQIZIMIT SOCIAL-EKONOMIK NË KOMUNITETET MINORITARE NË KOSOVË.....	23
9.1 Faza përgatitore.....	23
9.2 Zbatimi i aktivitetit.....	23
10. BASHKËPUNIMIT NË MES TË ETNITETEVE TË GRAVE NË KOMUNËN E VUSHTRRISË.....	23
11. MBËSHTETJA E PËRPUNUESVE TË USHQIMIT NË KOMUNAT- PRISHTINË, NOVOBËRDË, KAMENICË DHE RANILLUG PUBLIKIMET.....	24
LISTA E FLETËPALOSJEVE TË PUBLIKUARA.....	25
LISTA E BROSHURAVE TË PUBLIKUARA.....	25
VIZITAT E STAFIT DHE VIZITAT ME FERMERË GJATË VITIT 2018.....	25
LISTA E STAFIT TË IADK-SË PËR VITIN 2018.....	25
TË HYRAT E IADK-SË NGA DONATORËT PËR VITIN 2018.....	26
TË HYRAT E IADK-SË NGA PARTNERËT PËR VITIN 2018.....	26

TË ARRITURAT NË VITIN 2018

• Përkrahje direkte me grante

Edhe këtë vit IADK ka vazhduar përkrahjen direkte për fermerët, të rinjtë, studentët, gratë dhe grupet e grave. Kështu gjithësej janë përkrahur me grante të ndryshme 151 përfitues, dhe 160 të rinjë me pajisje esenciale për punë. Mbështetja me grante edhe këtë vit ka qenë e orijentuar në investimet për ngritje të kapaciteteve prodhuese dhe përpunuese si janë: (serra për kultivim të perimeve, serra tharëse për bimë mjekësore, ngritje të pemishteve me arra, ngritje të plantacioneve me bimë mjekësore, mekanizëm dhe pajisje bujqësore, pajisje për bletari, laktofriza për ruajtje të qumështit, investime në ngritje të pikave për përpunim të pemëve dhe perimeve, si dhe për përgatitjen e ushqimeve të ndryshme).

• Përkrahje e fermerëve dhe të rinjëve në avancimin e njohurive profesionale në bujqësi

Ky vit ka qenë i veçant për sa i përket mbajtjes së trajnimeve dhe këshillimeve të fermerëve dhe sidomos ngritjes profesionale për të rinjtë në sektorin e bujqësisë dhe përpunimit të prodhimeve bujqësore, kjo falë edhe një projekti veçmas për të rinjtë, të cilin IADK e ka zbatuar gjatë vitit 2018, e që në fokus kishte ngritjen e kapaciteteve profesionale për të rinjtë. 2793 fermerë, studentë, inxhinier të bujqësisë dhe punëtorë instucional janë trajnuar në 282 sesione të trajnimeve. Trajnimet kanë përfshirë gjithë sektorët e bujqësisë dhe përpunimit të prodhimeve bujqësore, si dhe trajnime për procedurat dhe rregullat e MSA-së.

• Vizitat për shkëmbim të përvojave

Po ashtu në këtë vit janë organizuar një numër i madhë i vizitave sidomos brenda vendit, në të cilat janë shkëmbyer përvoja të ndryshme në fushën e bujqësisë në mes të fermerëve dhe të rinjëve. Gjithësejt janë organizuar 20 vizita në vend, regjion dhe në vendet e BE ku kanë marr pjesë 353 pjesëmarrës.

• Ndikimi në punësim

Përkrahjet e përvitshme të cilat i bënë IADK përmes projekteve të ndryshme, qëllim parësor kanë krijimin e kushteve për punësim apo vet-punësim të përfituesve dhe familjeve të tyre. Kësisoj përmes

investimeve direkte nga zbatimi i projekteve të ndryshme, në këtë vit IADK ka përkrahur:

- 160 të rinjë me pajisje esenciale për punë
- 57 përfitues me bimë mjekësore
- 27 përfitues me mekanizëm bujqësor
- 25 përfitues me serra
- 12 përfitues me pemishte me arra
- 11 përfitues me pajisje për bletari
- 10 përfitues me laktofriza
- 1 përfitues me pemishte të dredhëzave
- 1 përfitues me pajisje për përpunim
- 1 përfitues me infrastruktur të objektit

Po ashtu janë themeluar këto biznese të reja:

- 2 njësi për përgatitjen e ëmbëlsirave
- 3 njësi për përpunim të pemëve/perimeve
- 1 bye shkollore

• Shtrirja e aktiviteteve në gjithë vendin

Edhe pse disa projekte kanë shtrirje të kufizuara në regjione apo komuna të caktuara konform thirrjeve për aplikim, kërkesës së donatorëve, apo kriterëve specifike gjatë përpilimit të projekteve, megjithatë këtë vit IADK ka arritë me disa projekte të shtrij aktiviteteve e saja në gjithë vendin, duke kontribuar në përkrahjen direkte të fermerëve për rritjen e kapaciteteve prodhuese dhe atyre profesionale.

• Identifikimi i përfituesve

Për sukses dhe qëndrueshmëri të aktiviteteve përkrahëse të fermerëve, IADK i kushton kujdes të shtuar përzgjedhjes së përfituesve, duke bërë vizita në terren dhe përdorur formularët e poentimit, sipas kriterëve të përcaktuara me projekt. Përzgjedhja e përfituesit të merituar për përkrahje garanton arritjen e objektivave dhe rezultateve të projektit, si dhe shfrytëzimin e drejtë dhe afatgjatë të të mirave të ofruara.



PARTNERËT DHE DONATORËT E IADK-së GJATË VITIT 2018

Sikurse edhe viteve tjera IADK dhe zhvillimi i saj, është i ndërlidhur me përkrahjen dhe bashkëpunimin e donatorëve dhe partnerëve të ndryshëm brenda dhe jashtë vendit. Ata tashmë e kanë besimin e plotë në profesionalizmin dhe transparencën e punës që bënë stafi i IADK-së gjatë zbatimit të projekteve.

Në vitin 2018 IADK ka vazhduar të zbatojë projektet e mëposhtme me përkrahje nga donatorët e ndryshëm, si janë:

• **Brot für die Welt (BfdW):** "Mundësimi i vetpunësimit të rinisë dhe grupeve të marginalizuara në viset rurale të Kosovës"

• **Brot für die Welt (BfdW):** "Përkrahja e fermerëve të vegjël me pajisje dhe promovimi i energjisë së ripërtëritshme"

• **UNDP:** "Mbështetja e fuqizimit ekonomik të fermerëve të vegjël në komunat veriore të Rajonit të Mitrovicës"

• **GIZ:** "Mbështetja e zinxhirit të vlerave të BMA përmes krijimit të punësimit dhe vazhdimet të

eksportit"

• **GIZ:** "Përfshirja ekonomike e të riatdhesuarve përmes bujqësisë në zonat rurale dhe ngritja e kapaciteteve përmes trajnimeve profesionale"

• **KCSF:** "Ngritja e kapaciteteve profesionale të të rinjve në sektorin e bujqësisë"

• **KCSF:** "Promovimi i MSA dhe rëndësisë së eksportit të produkteve bujqësore"

• **KCSF:** "Monitorimi i procesit të konsultimeve publike në nivel të qeverisë 2018"

• **DRC:** "Mbështetja e Ndërmarrësisë Shoqërore dhe Promovimi i Fuqizimit Social-ekonomik në Komunitetet Minoritare në Kosovë"

• **CDF:** "Krijimi i bashkëpunimit në mes të etniteteve të grave në komunën e Vushtrrisë"

• **CARE:** ka kontraktuar IADK-në për ofrimin e shërbimeve këshillimore për klientët të cilët i ka përkrah me pajisje apo mjete për akvite bujqësore.

1. MUNDËSIMI I VETËPUNËSIMIT TË RINISË DHE GRUPEVE TË MARGJINALIZUARA NË VISET RURALE TË KOSOVËS

Ky projekt është financuar nga Donatori BfdW nga Gjermania dhe ka periudhën tre vjeçare të zbatimit (2017-2019), ndërsa është bashkëfinancuar edhe nga komunat ku janë kryer investimet.

Gjatë vitit të dytë të zbatimit janë realizuar përkrahje të rëndësishme për fermerët, të rinjtë, studentët, gratë, grupet e grave dhe minoritetet në komunat: Vushtrri, Mitrovicë, Zubin Potok, Skënderaj, Shtime dhe Ferizaj. Përkrahjet direkte për fermerët janë bërë përmes ofrimit të granteve në sektorët e ndryshëm të bujqësisë, derisa studentët janë përkrahur me punë praktike për avancim të profesinit të tyre në fushën e bujqësisë dhe teknologjisë ushqimore. Në aspektin e ngritjes profesionale janë mbështetur edhe fermerët e rinj në sektorin e blegtorisë, ndërsa për gratë dhe grupet e grave janë realizuar investime të rëndësishme të cilat kanë ndikuar në hapjen e bizneseve të reja dhe vetë-punsim të grave. Po ashtu përmes projektit janë realizuar edhe vizita studimore si dhe përkrahje të fermerëve për pjesmarrje në panairë brenda dhe jashtë vendit.

GRANTET PËRKRAHËSE PËR FERMERËT DHE GRATË NË BIZNES

Gjatë vitit 2018 janë shpërndarë grante përkrahëse për fermerët në fusha të ndryshme të bujqësisë, me ndikim në krijimin e kapaciteteve prodhuese e përpunuese dhe përmirësimin e kualitetit të prodhimeve bujqësore. Përmes përkrahjes me grante janë bërë investime në ngritjen e serra, kultivimin e bimëve mjekësore, ngritjen e pemishteve me arra, pastaj investime në sektorin e blegtorisë (laktofriza për qumësht dhe pajisje për bletari), si dhe investime për gratë apo grupet e grave për krijimin e bizneseve për përgatitje të ushqimeve, embëlsirave, dhe përpunimin e pemëve e perimeve.

Krahas përkrahjes direkte të përfituesve është ofruar edhe asistencë profesionale përmes trajnimeve, këshillimeve direkte dhe vizitave për shkëmbim të përvojave në fushat përkatëse të bujqësisë.

1.1 Ngritja e serrave me sipërfaqe prej 160 m²

Për krijimin e kushteve më të favorshme për kultivimin e perimeve janë përkrahur 8 përfitues në ndërtimin e serrave, prej të cilëve 6 përfitues në Komunën e Skenderajt dhe 2 përfitues në Komunën e Zubin Potokut. Pakoja përkrahëse në këtë investim për secilin nga përfituesit përfshinë: serrën me sipërfaqe prej 160 m², me konstruksion nga metali i galvanizuar, 500 fidanë të perimeve ku më shumë ka pasë kërkesa për fidanë të specit, foljen e zezë për mulqirim të tokës, sistemin e ujitjes dhe rrjetën e gjelbër për hijezim të serrës. Përveç përkrahjes direkte me serra, fidanë perimesh dhe inpute tjera përcjellëse, për përfituesit e serrave IADK ka ofruar edhe asistencën profesionale për teknologjinë e kultivimit të perimeve në serra.



Figura 1: Keshilla direkte te përfituesja e serres Drita Mala - Skenderaj

Të hyrat nga shitja e perimeve ndryshon në varësi të llojit të perimeve që janë kultivuar, vendit dhe mënyrës së plasimit të perimeve, lëvizjeve të çmimeve të perimeve në tregun me shumicë etj. Pas përpunimit të të dhënave nga 8 përfituesit e serrave, është nxjerrë mesatarja e prodhimit nga një serrë që është 2165 kg, dhe të hyrat mesatare për përfitues janë 1435 €. Pas heqjes së perimeve kryesore, serrat janë mbjellë me perime vjeshtore dhe në këtë mënyrë fermerët do të kenë të ardhurat shtesë nga kultivimin i dytë i perimeve siç janë sallata, qepë, spinaq etj.

1.2 Ngritja e pemishteve me arra me sipërfaqe prej 0.50-0.80 ha


Edhe këtë vit në sajë të kërkesave dhe interesimit të fermerëve për kultivim të arrave, janë mbështetur gjithsejt 12 përfitues për ngritjen e pemishteve me arra, prej tyre 7 në Vushtrri, 3 në Mitrovicë dhe 2 në Skënderaj. Pakoja përkrahëse për pemishte përmban: 110-170 fidanë të arrës, komplet sistemin e ujitjes pikë-pikë përfshirë edhe rezervuarin me kapacitet prej 2000 litrave, pastaj 300 – 400 kg plehë artificial, shtyllat nga betoni dhe rrjetën metalike për rrethojnë e pemishteve, dhe po ashtu janë bërë analizat e tokës për përcaktimin e pllëshmërisë së tokës dhe përshtatshmërinë e tyre për kultivim të arrave.



Figura 2: Vizita studimore me përfituesit e pemishteve të arrave

1.3 Ngritja e plantacioneve me bimë mjekësore

Për kultivim të bimëve mjekësore janë përkrahur dy fermere nga Komuna e Mitrovicës të cilat kanë ngritur plantacione me rigon të bardhë me sipërfaqe nga 2000 m². Pakoja përkrahëse për këtë aktivitet përfshinë furnizimin me fidanë të rigonit të bardhë, pastaj sistemin komplet të ujitjes pikë-pikë, dhe një serrë tharëse me sipërfaqe prej 60 m² për tharjen e masës bimë pas kositjes.



Për përfitueset janë ofruar trajnimet për menaxhim biznesi dhe mbajtje të shenimeve të fermës, dhe po ashtu edhe këshilla direkte për të gjithë teknikën e kultivimit të kësaj bime, duke filluar që nga; përgatitja e tokës, mbjellja e fidanëve, kositja, tharja dhe deponimi. Viti i parë i kultivimit më tepër është vit i ngritjes së plantacionit me këtë kulturë dhe të hyrat janë simbolike, mirëpo nga viti i dytë e tutje për pesë vite radhazi bimët do të shtojnë masën vegjetative dhe do të kemi të hyra afatgjate me shpenzime minimale për mirëmbajtje të ngastrave nga barojat e këqija.



Figura 3: Ngastra me rigon të bardhë te përfituesja Hata Haxhiu - Mitrovicë

1.4 Laktofrizat për deponim dhe ruajtje të qumështit

Me qëllim të përmirësimit të kualitetit të qumështit këtë vit janë mbështetur 8 fermer me laktofriza për deponim dhe ruajtjen e qumështit, prej tyre 6 fermer në Komunën e Ferizajt dhe 2 fermer në komunën e Shtimes. Përveç furnizimit me nga një laktofriz me kapacitet prej 300 litrave, ata janë furnizuar edhe me nga 5 bidona të qumështit me kapacitet prej 20 litrash për vendosjen e qumështit menjëherë pas mjeljes dhe dergimin e tij deri në laktofriz. Në sajë të këtyre investimeve për përfituesit janë krijuar kushte më të mira për grumbullimin dhe ruajtjen e qumështit dhe me këtë është ndikuar në përmirësimin e cilësisë së qumështit dhe rritjen e vlerës së tij, ngase ata më parë qumështin e kanë deponuar në enë dhe bidona të ndryshëm ndërsa ruajtjen e tij e kanë pasur shumë të vështirë për shkak të mungesës së laktofrizave. Po ashtu me këto investime është lehtësuar shumë puna e fermerëve, pastaj është rritë kualiteti i qumështit, e me këtë janë ngrit të hyrat nga shitja e qumështit me çmim më të favorshëm për shkak të cilësisë më të mirë.

Përfituesit janë mbështetur edhe me asistencë profesionale si nga aspekti i menaxhimit të fermës dhe mbajtjes së shënimeve, ashtu edhe nga aspekti praktik janë ofruar këshilla direkte.



Figura 4: Përfituesi i laktofrizit Rexhep Jetishi - Ferizaj

Për shkëmbim të përvojave më të mira në mabreshtimin e kafshëve dhe menaxhimin e fermave me përfituesit është organizuar edhe një vizitë në një fermë intensive të lopëve qumështore në Prizren, në të cilën janë parë mënyrat e organizimit të punëve në fermë, mënyrat e të ushqyerit të kafshëve, sistemi i mjeljes, higjiena e mirë brenda dhe jashtë stallës, dhe informacione rreth tregtimit të prodhimeve nga kjo fermë.

1.5 Trajnimi profesional i grupit të fermerëve në blegtori

Në këtë aktivitet IADK ka përzgjedhur një grup prej 14 fermerësh nga Komuna e Ferizajt dhe e Shtimes, të cilët merren me mbarështimin e kafshëve, dhe kanë shpreh interesimin e tyre për ngritjen e nivelit të njohurive në sektorin e blegtorisë, me qëllim të menaxhimit më profesional të fermave dhe rritjen e përfitimeve në ekonominë e tyre familjare. Figura : Trajnimi teorik i fermave të sektorit të blegtorisë Figura : Trajnimi praktik i fermerëve të sektorit të blegtorisë

Trajnimi i këtyre fermerëve është realizuar në periudhën kohore nga 19 Prill 2018 deri 06 Korrik 2018.



Figura 5: Trajnimi teorik i fermave të sektorit të blegtorisë



Figura 6: Trajnimi praktik i fermerëve të sektorit të blegtorisë

Pas përfundimit të trajnimeve fermerët janë certifikuar dhe kanë marrë titullin “Teknik i Blegtorisë” në nivelin e tretë sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve si dhe standardit të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve. Ndërsa certifikatat janë lëshuar nga IADK dhe verifikuar nga “Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve”. Përmes këtij programi të avancuar të ofrimit të trajnimeve teorike dhe praktike është ngritur kapaciteti profesional i fermerëve në sektorin e blegtorisë, dhe në këtë mënyrë do të ketë ndikim edhe në ngritjen e prodhimit në ferma dhe përmirësimin e kualitetit të këtyre prodhimeve.

1.6 Investimet në sektorin e bletarisë-pajisje

Ky investim është bërë me qëllim të avansimit të sektorit të bletarisë me pajisje më profesionale për vjeljen dhe deponimin e mjaltit. Për lehtësimin e punës dhe ruajtjen e cilësisë së mjaltit gjatë vjeljes dhe deponimit janë përkrahur 4 fermer në Komunën e Mitrovicës, të cilët janë duke u marrë me kultivimin e bletëve. Pakoja përkrahëse për secilin përfitues përfshinë furnizimin me pajisjet si janë: centrifugë elektrike kasetare, shkrirëse dylli elektrike, vaskë për hapjen e hojeve, bidona për deponim të mjaltit, telngjitës rryme dhe pajisje tjera të vogla.

Për përfituesit janë ofruar trajnimet për menaxhim biznesi dhe mbajtje të shënimeve të fermës, pastaj udhëzime për përdorim të pajisjeve dhe këshilla direkte për praktikën e kultivimit të bletëve.

Bletaria është një sektor specifik që varet shumë nga kushtet klimatike sidomos në sezonën pranverë-verë, por njëkohësisht edhe nga njohuritë dhe përkushtimi i kultivuesve në këtë veprimtari. Pajisjet e shpërndara përmes këtij investimi kanë një ndikim shumë të rëndësishëm për organizimin më të mirë të punëve në bletari, do të rrisin motivimin e fermerëve për të zgjeruar kapacitetet prodhuese të mjaltit dhe të ruajnë cilësinë e mjaltit.



Figura 7: Shpërndarja e pajisjeve të bletarisë

1.7 Ngritja e njësisë për përgatitjen e ëmbëlsirave

Me qëllim të krijimit të kushteve për përfshirjen e grave në biznes edhe këtë vit janë realizuar përkrahje të ndryshme për promovimin e rolit të gruas në hapjen e vendeve të punës.

Në Komunën e Shtimes janë bërë investime të rëndësishme për ngritjen e njësisë për përgatitjen e ëmbëlsirave. Përfituesja e kësaj njësie është Xhevahire Mustafa nga Shtimja, e cila edhe ka pasë traditë të mëhershme familjare në përgatitjen e ushqimeve tradicionale dhe ëmbëlsirave, por kushtet e punës kanë qenë të vështira dhe nuk ka poseduar pajisje profesionale për këtë aktivitet. Përmes këtij projekti ajo është furnizuar me pajisje të nevojshme për zhvillimin normal të kësaj veprimtarie, siç janë: frigorifer vertikal-700 litra, furrë profesionale për pjekje, tavolinë mbajtëse për furrë, shok komore, mikser planetar për ëmbëlsira, mikser spiral për brum, tavolinë pune e hapur, lavaman, rafte vjerrëse, tavolinë pune inoks, raft metali dhe pajisje tjera të vogla.

Në aspektin e marketingut përfituesja është pajisur me barkod të lëshuar nga Oda Ekonomike e Kosovës, si dhe janë dizajnuar etiketat për lloje të ndryshme të ëmbëlsirave, të cilat identifikojnë biznesin dhe mundësojnë plasimin e produkteve edhe në markete të vogla dhe qendra tregtare. Tani ajo ka legalizuar biznesin e saj dhe ka punësuar edhe 5 gra tjera, duke kontribuar kështu me punën edhe angazhimin e suksesshëm që biznesi i saj të jetë burim i rëndësishëm për krijimin e të hyrave jo vetëm për familjen e saj por edhe për 5 familje tjera.



Figura 8: Njësi për përgatitjen e ëmbëlsirave të përfituesja Gjevahire Mustafa - Shtime

1.8 Investimet në bufen e shkollës

Edhe në këtë investim janë krijuar kushte për punësimin e katër grave, të cilat përgatisin ushqime për nxënësit gjatë kohës kur zhvillohet procesi mësimor. Hapja e bufësë është bërë në Shkollën Fillore "Emin Duraku" në Shtime, ku paraprakisht IADK ka përkrahur grupin e grave prej 10 vetave për të ndjekur kursin e trajnimeve intensive për gatimin e ushqimeve të ndryshme për kuzhinën shkollore, të cilat janë aftësuar në mënyrë profesionale të gatujnë recptura të ndryshme ushqimore. Pas përfundimit të kursit trajnues është bërë selektimi i 4 grave më të suksesshme dhe të motivuara për gatim të ushqimeve, të cilat janë punësuar në byfe dhe krijojnë të hyra për familjet e tyre.

IADK ka furnizuar kuzhinën me të gjitha pajisjet e nevojshme për gatim të ushqimeve dhe ka krijuar kushte të përshtatshme për punë normale të grupit të grave, të cilat gatujnë ushqime cilësore dhe të sigurta për nxënësit.

Gjithashtu IADK ka bërë edhe certifikimin e 4 grave të punësuar në byfe, dhe 6 grave tjera të cilat kanë përcjellur kursin trajnues për përgatitjen e ushqimeve, e që do ta kenë më të lehtë punësimin në një biznes të ngjashëm në të ardhmen.



Figura 9: Trajnimi i grupit të grave për përgatitjen e ushqimeve për bufë

1.9 Ngritja e njësisë për përpunimin e pemëve dhe perimeve

Në këtë komponentë paraprakisht janë mbajtur trajnimet me tri grupe të grave, të cilat janë ngritur së pari në aspektin profesional në fushën e përpunimit të perimeve dhe menaxhimit të biznesit. Kursi trajnues është zhvilluar në aspektin teorik dhe më tepër në aspektin praktik, ku janë demonstruar teknologjitë dhe recepturat e ndryshme të përpunimit shtëpiak dhe mënyrat e konservimit të perimeve. Të tri grupet janë aftësuar profesionalisht për të përpunuar dhe konservuar në mënyrë cilësore perime të ndryshme.

Pas përfundimit të trajnimeve me këto tri grupe të grave është organizuar ceremonia e certifikimit të tyre, dhe janë certifikuar 31 kandidatë që kanë kaluar kriterin e vijueshmërisë në trajnime.

Për përkrahje me pajisje të nevojshme për ngritjen e njësisë përpunuese të pemëve dhe perimeve është zgjedhur përfituesja Lumturie Maloku nga fshati Pleshinë – Ferizaj. IADK ka kryer investimet në sigurimin e pajisjeve të nevojshme për funksionalizimin e njësisë përpunuese, si dhe ka dhënë udhëzimet më të nevojshme për mënyrën e shfrytëzimit të tyre.



Figura 10: Trajnimi i grave për përpunim të perimeve - Ferizaj

Ngritja e kësaj njësie përpunuese do të përmirësojë gjendjen ekonomike të familjes përfituese, por do të ketë ndikim edhe për gratë tjera të cilat kanë ndjekur kursin trajnues, si dhe fermerët tjerë që merren me kultivimin e perimeve, ngase do të kenë mundësinë e dorëzimit të perimeve për përpunim në këtë pikë.

Përfituesja është përkrahur edhe në aspektin e marketingut, ku janë diznuar dhe prodhuar 5 lloje të etiketave të produkteve të ndryshme dhe një baner për vizibilitet gjatë ekspozimit dhe tregtimit të produkteve në tregje dhe panaire të ndryshme, si dhe është pajisur me barkod të lëshuar nga Oda Ekonomike e Kosovës.



Figura 11: Promovimi i Njësisë për përpunimin e pemëve dhe perimeve në Peshinë - Ferizaj

1.10 Investime në përmirësim të infrastrukturës së objektit

Në këtë investim është përkrahur përfituesja Sela Imeri nga fshati Çabër, Komuna Zubin Potok, për përmirësimin e infrastrukturës së objektit të cilin e shfrytëzon për përgatitjen e ushqimeve tradicionale dhe përgatitjen e ëmbëlsirave. Ajo kishte një traditë dhe përvojë të mirë në këtë aktivitet, porse avancimi i kësaj veprimtarie ishte i vështirë në kushtet në të cilat punonte.

Ajo kishte marrë edhe një premtim nga USAID-i për përkrahje me pajisje për punë, me kusht nëse paraprakisht bënë rregullimin hapsirës punues, e që ishte e pamundur për të vet financuar këtë investim. IADK duke parë interesimin dhe motivimin e saj për punë, ka përkrahur një pjesë të investimeve duke e furnizuar me dyer dhe dritare plastike, sipas standardeve të kërkuara për zhvillim të aktivitetit të lartcekur. Si rezultat i kësaj përkrahje ajo ka fituar edhe pajisje profesionale për punë të cilat do të ndikojnë në përmirësimin e cilësisë së produkteve dhe rritjen e prodhimit.

1.11 Përkrahja e studentëve në punë praktike

Edhe në vitin 2018 janë përkrahur me trajnime dhe sistemim në punë praktike 10 student/e nga komuna të ndryshme të Kosovës ku është duke u zbatuar projekti. Studentët e përzgjedhur janë sistemuar në punë praktike nëpër kompani dhe institucione për të cilat ata vet janë përcaktuar duke u bazuar në profilin e shkollimit të tyre. IADK gjatë punës praktike përmes projektit i ka kompensuar studentët me një pagë simbolike për të mbuluar shpenzimet e ushqimit, të komunikimit dhe të udhëtimit. Qëllimi i punës praktike është që të përgatisë studentët për tregun e punës, të fitojnë njohuri praktike në sektorin e bujqësisë, të lidhin njohuritë e tyre teorike me përvojën praktike dhe në këtë mënyrë do të kenë më të lehtë të qasjen në tregun e punës, apo të marrin iniciativa për vetë-punësim. Si rezultat i kësaj përkrahje 3 student, pas përfundimit të punës praktike janë punësuar në kompanitë/institucionet ku kanë kryer praktikën. Kjo përkrahje do të vazhdojë edhe në vitin 2019, duke mbështetur 10 student tjerë për kryerjen e punës praktike.



Figura 12: Trajnime me studentët e përzgjedhur për përkrahje në punë praktike

1.12 Panairët

Më 15 dhe 16 Maj 2018 IADK ka organizuar vizitën dy ditore në "Panairin Ndërkombëtarë të Bujqësisë" në Novi Sad, në të cilin kanë marrë pjesë 38 pjesmarrës, prej të cilëve fermer/e, si dhe zyrtar nga departamentet e bujqësisë të komunave ku shtrihet projekti. Panairi i Bujqësisë në Novi Sad ka traditë të gjatë dhe është një nga panairët më të njohur në Evropën Juglindore, dhe fermerët tanë kanë parë makineri të ndryshme bujqësore, pajisje për përpunim. Po ashtu është vizituar shtandi i blegtorisë me raca të ndryshme të gjedheve dhe deleve, pajisje për mjeljen e lopëve si dhe pajisje për analiza të qumështit, si dhe shtandet e bujqësisë organike. Po ashtu IADK ka kontribuar edhe në organizimin e Panairit Regjional "Mitrovica 2018, dhe ka mundësuar pjesmarrjen e fermerëve dhe grupeve të grave ekspozojnë prodhimet bujqësore, produktet e ndryshme të përpunura, artizanate të ndryshme etj.



Figura 13: Pamje nga vizita e fermerëve në Panairin për Bujqësi në Novi Sad

2. PËRKRAHJA E FERMERËVE TË VEGJËL ME PAJISJE DHE PROMOVIMI I ENERGJISË SË RIPËRTËRITSHME

Ky projekt është financuar po ashtu nga Donatori Bread for the World nga Gjermania dhe ka periudhën gjasht mujore të zbatimit (Shtator 2018/Shkurt 2019). Në fokus të projektit janë investimet për të ngritjen e mëtejme të kapaciteteve profesionale dhe operacionale të IADK-së, si dhe për përkrahjen e mëtejme të sektorit të bujqësisë dhe zhvillimit rural të vendit.

Investimet në rritjen e kapaciteteve të IADK-së përfshijnë furnizimin me pajisje të ndryshme teknologjike si janë: kompjuter, laptop, printera, aprate digjitale, pajisje për përpunimin e prodhimeve bujqësore dhe gatimin e ushqimeve të ndryshme, të cilat do të vendosen në dhomën për demonstrim praktik gjatë trajnimeve me fermer/e në IADK. Po ashtu për shkak të lehtësisë të transportit të fermerëve, grupeve të grave, si dhe vet stafit të IADK-së, gjatë trajnimeve në teren apo vizitave të ndryshme, IADK është furnizuar edhe me një minibus me 8 ulëse.

Një investim i rëndësishëm që do të ulë koston për energjisë në objektin e IADK-së, po ashtu do të jenë edhe panelet solare fotovoltaike për prodhim të energjisë së ripërtrishme me kapacitet 10 kW, që do të vendosen në çati të objektit dhe prodhojnë energji elektrike për nevoja të IADK-së, ndërsa teprica e energjisë do të shkarkohet në rrjetin elektrik të KEDS-it, dhe në fund të vitit do të bëhet bilanci për diferencën mes energjisë së prodhuar dhe asaj të shpenzuar.

Investimet në përkrahje të sektorit të bujqësisë janë realizuar duke mbështetur fermerët me grante të ndryshme, me qëllim të krijimit të kapaciteteve prodhuese dhe përpunuese, si dhe mekanizëm bujqësor për lehtësim dhe efektivitet të punës në bujqësi.

Mbështetja e sektorit të bujqësisë përmes projektit është bërë në Komunën e Vushtrrisë, Mitrovicës, Zubin Potokut, Skënderajt dhe Shtimes, ku janë përkrahur me grante të ndryshme në sektorin e bujqësisë dhe përpunimit, fermer të rinjë, student të diplomuar në fakultetin e bujqësisë dhe veterinarisë, gratë, dhe minoritetet. Në kuadër të projektit këtë vit janë shpërndarë 45 grante të ndryshme të përfituesit, varësisht nga nevojat dhe kapacitetet e tyre prodhuese, të cilat janë paraqitur në tabëlën vijuese:

Numri i përfitueseve me grante të ndryshme - sipas komunave dhe sektorëve							
Nr.	Komuna	Serra 200 m ²	Paisje për bletari	Mekanizëm bujqësor	Laktofriza për qumësht	Pajisje për përpunim	Total
1	Vushtrri	3	2	15	2	0	22
2	Mitrovicë	1	3	5	0	1	10
3	Skenderaj	2	2	2	0	0	6
4	Shtime	0	0	4	0	1	5
5	Zubin Potok	0	0	1	0	1	2
Gjithësej		6	7	27	2	3	45

Tabela 1: Përfituesit sipas komunave dhe sektorëve

2.1 Ngritja e serrave me sipërfaqe prej 200 m²

Për krijimin e kushteve më të favorshme për kultivimin e perimeve janë përkrahur 6 përfitues në ndërtimin e serrave. Pakoja përkrahëse në këtë investim për secilin nga përfituesit përfshinë: serrën me sipërfaqe prej 200 m², me konstruksion nga metali i galvanizuar, 1500 fidanë të sallates së gjelbert, 1 kg farëra të spinaqit, sistemin e ujitjes, rrjetën e gjelbër për hijezim të serrës, agro folie, dhe folien e zezë. Përveç përkrahjes direkte me serra, fidanë perimesh dhe inpute tjera përcjellëse, IADK ka monitoruar nga afër përfituesit duke dhënë udhëzime të nevojshme për kultivim të perimeve. Të gjithë përfituesit kanë përgatitur me kohë serrën dhe kanë kryer mbjelljen e serrave me perime vjeshtore, dhe vjelja e tyre pritet të bëhet në fillim të vitit të ardhshëm varësisht prej kushteve klimatike që do të mbretërojnë.



Figura 14: Përfituesja e serrës Shefkie Shala - Vushtrri

2.2 Investimet në sektorin e bletarisë - pajisje

Në këtë sektor janë përkrahur gjithësejt 7 përfitues të cilët merren me kultivimin e bletëve. Përmes granteve përfituesit janë furnizuar kryesisht me disa pajisje më të avancuara, të cilat lehtësojnë punën e bletarëve dhe ruajnë cilësinë e mjaltit. Pakoja përkrahëse për secilin përfitues përfshinë furnizimin me pajisjet siç janë: centrifugë elektrike kasetare, shkrirëse dylli elektrike, vaskë për hapjen e hojeve, bidona për deponim të mjaltit, duplikator, telngjitës rryme, çpojësë për korniza, bluzë mbrojtëse për bletar, dorëza për bletar nga lëkura, tymuese standarde, kullojëse për vjeljen e mjaltit, thika amerikane për punë me korniza, brusha për largimin e bletëve nga korniza, pirun për shpuarjen e hojeve. Për përfituesit janë ofruar këshilla dhe udhëzime për përdorim të pajisjeve dhe monitorime për praktikën e kultivimit të bletëve, varësisht nga nevojat e bletarëve dhe gjendjes në teren.



Figura 15: Shpërndarja e pajisjeve për bletari të përfituesja Lumturije Fejza - Mitrovicë

2.3 Laktofriza për ruajtje të qumështit

Sektori i prodhimit të qumështit është një nga sektorët më të ndjeshëm sa i përket higjienës në stalla dhe pajisjeve që përdoren gjatë mjeljes dhe deponimit të qumështit. Për të zvogëluar ndikimin e faktorëve të jashtëm sidomos të bakterieve, IADK ka përkrahur 2 përfitues me nga një laktofriz me kapacitet prej 300 litra, derisa njeri nga përfituesit është furnizuar edhe me makinë mjelëse me dy njësi. Në mungesë të laktofrizit fermëruve shpesh u është prishur qumështi dhe e kanë hudhur, sidomos në sezonën e verës kur temperaturat janë të larta, andaj përmes këtyre përkrahjeve është ndikuar në evitimin e humbjeve dhe përmirësimin e cilësisë së qumështit, që konsiston edhe në rritjen e të hyrave nga shitja e qumështit dhe përfitimit të pagesës direkte për qumësht të ekstra klasës. Fermeret janë udhëzuar për përdorimin e laktofrizit, mbajtjen e higjienës, adaptimin e vendit për vendosje të laktofrizit sipas standardeve të përcaktuara për shfrytëzim sa më të lehtë.



Figura 16: Shpërndarja e laktofrizave të përfituesit - Vushtrri

2.4 Mekanizëm/pajisje bujqësore

Për një prodhimtari më të lartë si në bujqësi ashtu edhe në blegtori, ndikim shumë të madhë kanë edhe mjetet bujqësore të cilat fermerët i disponojnë. Përfituesit e përkrahur me mekanizëm bujqësor kanë pasur fare pak mjete bujqësore, dhe përmes këtyre granteve, do ta kenë më të lehtë organizimin dhe kryerjen me kohë të punëve në bujqësi, e me këtë do të arrijnë edhe rritjen e prodhimit për njësi të sipërfaqes. Në komunat ku shtrihet projekti 27 përfitues janë furnizuar me mekanizëm të ndryshëm bujqësor, në varësi të veprimtarive të tyre bujqësore, nevojave për llojin e mekanizmit dhe buxhetin e planifikuar për këto investime. Mekanizmi apo pajisjet bujqësore të cilat janë shpërndarë të përfituesit përfshijnë furnizimet me : kosë për kositje të barit, grabuja, rimorkio, motokultivator, freza, stërpikëse, pijatorë, pllugje, trina, mulli për bluarje me përzierëse, mbjellëse misri, gërrshërë elektrike për krasitje të pemëve, duplikator, pasterizator, peshore etj.



Figura 17: Shpërndarja e mekanizmit bujqësor - Vushtrri

2.5 Ngritja e njësisë për përgatitjen të ëmbëlsirave

Edhe në këtë projekt kemi pasur kërkesa nga gratë ndërmarrëse për përkrahje të ideve të tyre në hapjen e bizneseve familjare, përmes së cilave synojnë hapjen e vendeve të punës për familje dhe më gjërë. Në këtë mënyrë përfituesja Elmaze Dauti nga Komuna e Shtimes, është njëra nga përfitueset e investimeve shumë të rëndësishme në ngritjen e njësisë për përgatitje të ëmbëlsirave. Ajo merrej me këtë veprimtari në kushte shumë të vështira dhe me pajisje shumë të thjeshta, e me infrastrukturë jo adekuate. Investimet e realizuara përmes këtij projekti kanë krijuar kushte shumë të mira për zhvillimin e kësaj veprimtarie, e të cilat do të kenë efekt në zgjerimin e prodhimit, përmirësimin e kualitetit të produkteve dhe rritjen e punësimit. Përfituesja është furnizuar me këto pajisje: frigorifer vertikal 900 litra, furrë profesionale për pjekje, tavolinë mbajtëse për furrë, shok komore, mikser planetar për ëmbëlsira, tavolinë pune e hapur, lavaman, rafte vjerrëse, tavolinë pune inox, raft metali, shporet me 4 flakadana, karrocë inox me kapak, bojler me kapacitet 80 l, peshore elektrike, pajisja me barkod, etiketa, fletpalosje.



Figura 18: Njësia për përgatitjen e ëmbëlsirave të përfituesja Elmaze Dauti - Shtime

2.6 Ngritja e pikave përpunuese për pemë dhe perime

Një përkrahje tjetër shumë e rëndësishme për mbështetjen e iniciativave biznesore të grave, janë edhe investimet në ngritjen e dy njësive përpunuese të pemëve dhe perimeve. Njëra njësi është krijuar në Mitrovicë të përfituesja Drita Kadriu dhe tjetra në Zubin Potok të përfituesja Gordana Bozovic. Për zhvillimin normal të kësaj veprimtarie të dy përfitueset janë përkrahur me pajisje më se të nevojshme, si janë: vitrin vertikale, peshore, duplikator, makinë për bluarjen e frutave dhe perimeve, termometer digjital, lavaman, pasterizator, sistem ventilimi, makinë vakumuese, rafta metalik, shporet me katër pllaka, raft për vendosje të produkteve, barkod, etiketa, logo, fletpalosje.



Figura 19: Njësia për përpunimin e pemëve dhe perimeve të përfituesja Drita Kadriu - Mitrovicë

3. MBËSHTETJA E FUQIZIMIT EKONOMIK TË FERMERËVE TË VEGJËL NË KOMUNAT VERIORE TË RAJONIT TË MITROVICËS

Ky projekt është përkrahur nga UNDP dhe është zbatuar në periudhën 3 mujore (29 Mars 2018 – 15 Qershor 2018) në komunat: Leposaviq, Zubin Potok, Mitrovica Veriore dhe Zvečan. Qëllimi i projektit ishte mbështetja e fuqizimit ekonomik të grave (si dhe burrave) duke ndihmuar fermerët e vegjël për të rritur kapacitetin e tyre prodhues, për të stimuluar gjenerimin e të ardhurave dhe për të përmirësuar mirëqenien e tyre dhe të familjeve të tyre përmes investimeve të vogla të përcjellura me këshilla dhe trajnime profesionale. Një fokus kyç i projektit ishte përforsimi i mëtejshëm i autonomisë dhe pavarësisë ekonomike të grave si të mbijetuara të dhunës në familje për të përmirësuar statusin e tyre ekonomik dhe për të zvogëluar rreziqet për t'u bërë viktime të dhunës me bazë gjinore.



Figura 20: Serra të përfituesja Liza Filipovic në Zvečan

Projekti ka kontribuar në fuqizimin ekonomik të fermerëve të vegjël në komunat veriore të Kosovës duke ndihmuar 10 gra dhe 2 burra, viktimë të dhunës me bazë gjinore, për të rritur kapacitetin e tyre të prodhimit, për të stimuluar gjenerimin e të ardhurave dhe për të përmirësuar mirëqenien e familjeve të tyre, përmes investimeve të vogla të plotësuar me këshilla direkte në fermë dhe përkrahejs me grante. 52 përfitues morën pjesë në trajnime profesionale të zhvillimit të aftësive për të ndërtuar kapacitetin e tyre, për të gjeneruar të ardhura nëpërmjet prodhimit bujqësor.

Në kuadër të projektit 12 përfitues janë përkrahur me grante direkte, ku prej tyre 11 përfitues kanë përfituar serra për perime me sipërfaqe 160m², me inpute përcjellëse dhe fidanë perimesh, ndërsa 1 përfitues është përkrahur në ngritje të pemishteve me dredhëz në sipërfaqe prej 1000m², me fidanë dhe inpute. Për përfituesit e projektit janë ofruar nga 5 këshilla të drejtpërdrejta nga ekspertët e IADK-së. Ndikimi i përgjithshëm i projektit ka qenë fuqizimi ekonomik i të mbijetuarve të dhunës në familje nga zonat rurale në katër komunat veriore të Kosovës: Leposaviq, Zubin Potok, Mitrovica Veriore dhe Zvečan, përmes ndërtimit dhe fuqizimit të kapaciteteve prodhuese për të përmirësuar mirëqenien të tyre.



Figura 21: Këshilla të përfituesit i dredhëzave
Rados Stevanovic - Zubin Potok

4. MBËSHTETJA E ZINXHIRIT TË VLERAVE TË BMA PËRMES KRIJIMIT TË PUNËSIMIT DHE VAZHDIMIT TË EKSPORTIT

Ky projekt është përkrahur nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, mandatar nga Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë dhe ka periudhën tre vjeçare të zbatimit (2018-2020). Projekti gjatë zbatimit do të përfshijë të gjitha komunat e Kosovës që kanë kushte të favorshme për prodhimtari të bimëve mjekuese dhe aromatike. Qëllimi i projektit është përmirësimi i qëndrueshmërisë së zinxhirit të vlerës për sektorin e bimëve mjekësore aromatike (BMA), përmirësimi i konsistencës në furnizimin dhe mbledhjen e BMA si dhe ngritja e kapaciteteve për pikat e grumbullimit të BMA dhe prodhuesit primar të kalojnë në prodhim organik. Projekti do të mbështesë fermerët në zonat rurale përmes shpërndarjes së granteve, dhe asistencës profesionale në aspektin teorik, e sidomos në atë praktik, me qëllim të krijimit të të ardhurave dhe përmirësimit të gjendjes ekonomike. Grupet e synuara të projektit janë: Prodhuesit primarë/mbledhësit e BMA, Pikat grumbulluese të BMA, dhe Kompania eksportuese "AgroProduct" SH.P.K.

4.1 Grantet përkrahëse për ngritje të plantacioneve me bimë mjekësore dhe aromatike

Në fazat fillestare të projektit, IADK ka nënshkruar Memorandum Mirëkuptimi (MoU) me kompaninë eksportuese "AgroProduct" SH.P.K për bashkëpunim dhe sigurim të tregut të BMA për të gjithë përfituesit e projektit, duke krijuar një qëndrueshmëri të përhershme të tregut për eksport për së paku 5 vite, pasi kjo kompani eksporton këto produkte në tregun evropian.

Gjatë vitit të parë të zbatimit të projektit janë realizuar përkrahje të rëndësishme për fermerët dhe pikat grumbulluese të bimëve mjekuese dhe aromatike në 19 komuna nga të gjitha regjionet e Kosovës. Në kuadër të projektit 55 përfitues janë përkrahur me bimë mjekësore dhe aromatike dhe pajisje përcjellëse, ku 30 prej tyre janë përkrahur me fidanë të Rigonit të Bardhë, 11 me material fidanor (rrënjë) Hithër, 5 me material fidanor (stolone nëntokësore) Mentë, 7 përfitues me Serra Tharëse si dhe 2 përfitues me Mekanizëm bujqësorë. Sipërfaqet e fushave kultivues me rigon të bardhë janë me nga 2000m², ndërsa për hithër dhe mentë me nga 5000m². Në kuadër të përkrahjes së 55 përfituesve me grante janë përfshirë edhe 9 pika grumbulluese të bimëve mjekuese dhe aromatike.

Përfituesit e përkrahur me BMA në vitin 2018																			
Komuna & Kulturat	Istog	Drenas	Vushtrri	Mitrovicë	Malishevë	Skenderaj	Gjilan	Suharekë	Rahovec	Prishtinë	Podujevë	Zubin Potok	Kaçanik	Kamenicë	Dragash	Ferizaj	Novobërdë	Pejë	Prizren
Rigon	9	2	1	1	1	3	1	1	2	3	2	2	1	1					
Hithër	1	2	1			1	1		1						2	1			1
Mentë	1								2		1			1					
Mekanizëm	1	1																	
Serrë tharëse			1		2		1										2	1	
Gjithësej	12	5	3	1	3	4	3	1	5	3	3	2	1	2	2	1	2	1	1
																			55

Tabela 2: Përfituesit sipas kulturave dhe komunave

Përfituesit e Rigonit të bardhë, Hithërit dhe Mentës përveç fidanëve kanë përfutuar edhe:

- Sistemin komplet të ujitjes pikë-pikë;
- Serra tharëse me rafte apo pa rafte me dimensione: 30m², 50 m², 80 m² dhe 100m²;
- Mekanizëm bujqësor;



Figura 22: Shpërndarja e motokultivatorëve të përfituesit në Komunën e Istogut



Figura 23: Shpërndarja e sistemit të ujitjes të përfituesi Sadri Asllani - Vushtrri

Rigoni, hithëri dhe menta janë bimë shumëvjeçare të cila nuk kërkojnë shpenzime gjatë vegjetacionit, përveç mirëmbajtjes së tokës nga barojat e këqija, ujitjen gjatë periudhave me thatësi dhe kositjen e tharjen e masës bimore. Viti i parë më tepër është vit i ngritjes së plantacionit dhe përgatitjes së bimëve për prodhim në vitet pasuese, pasi të mbjellat e këtyre bimëve janë bërë në sezonin e vjeshtës 2018, rendimentet e para do të jenë në vitin e ardhshëm. Mbjellja e sipërfaqeve me BMA është një investim i rëndësishëm për fermerët përfutues, nga se do të krijojnë të hyra afatgjate për 5-7 vite. Po ashtu fermerët kanë ndjekur këshilla dhe trajnime profesionale të ofruara nga IADK, dhe kështu fermerët kanë marrë njohuri shtesë që do të ju ndihmojnë në zgjerimin e sipërfaqeve të reja me BMA. Një vëmendje e veçantë do t'i kushtohet trajnimit të përfutuesve për metodat e prodhimit të organikë të këtyre bimëve dhe procesin e inspektimit dhe certifikimit. Përfutuesit dhe sidomos pikat grumbulluese do të ndihmohen për të zhvilluar procesin e gjurmueshmërisë së produkteve të mbledhura, kultivura apo të grumbulluara, duke përdorur sisteme adekuate për mbajtjen e shënimeve gjatë prodhimit, grumbullimit, blerjes dhe tregtimit të bimëve mjekësore aromatike.



Figura 24: Këshilla për mbjelljen e fidanëve të rigonit të përfutuesi Bashkim Krasniqi - Malishevë

5. PËRFSHIRJA EKONOMIKE E TË RIATDHESUARVE PËRMES BUJQËSISË NË ZONAT RURALE DHE NGRITJA E KAPACITETEVE PËRMES TRAJNIMEVE PROFESIONALE

Zbatimi i projektit "Përfshirja ekonomike e të riatdhesuarve përmes bujqësisë në zonat rurale dhe ngritja e kapaciteteve përmes trajnimeve profesionale", është përkrahur nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, i mandatuar nga Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë. Projekti ka filluar me 1 Shtator 2018 ndërsa përfundon në Qershor 2020, dhe do të ketë shtrirje në pesë komuna : Rahovec, Malishevë, Drenas, Skenderaj dhe Klinë.

Kosovarët janë grupi i dytë, më i madhi që kanë migruar kohëve të fundit në Gjermani duke përfshirë edhe valën e migrimit të viteve 2014/2015 me shpresë për të gjetur një jetë më të mirë dhe punë në perëndim. Shumica e të larguarve kanë shitur edhe pasurinë e tyre për të siguruar mjetet për të ikur jashtë vendit. Pas një periudhe shumë të shkurtër ata janë dëbuar dhe rikthyer në vendlindjen e tyre, të zhgënyer dhe me shpresa krejtësisht të thyera për të rifilluar jetën në Kosovë.

Qëllimi i projektit është ri-integrimi i të kthyrëve në shoqëri përmes gjenerimit të të ardhurave dhe trajnimit i të rikthyerve dhe familjeve në zonat rurale përmes shpërndarjes së granteve në formë të të mirave materiale; si serra, pemishte, pajisje, mekanizëm bujqësor dhe impute tjera sipas kërkesave dhe potencialit të tyre për veprimtari në sektorin e bujqësisë.



Figura 25: Mbajtja e sesionit informues në Komunën e Drenasit



Figura 26: Vizita në teren për përzgjedhjen e përfituesve

Edukimi dhe trajnimet profesionale janë parë si elementë kyç për të mundësuar popullsinë rurale për të filluar aktivitetet e biznesit bujqësor nëpërmjet bujqësisë me përpunues, përpunues dhe blerës të tjerë potencialë. Vlera e shtuar e projektit në aspektin e bujqësisë është dhënia e mbështetjes për prodhimin bujqësor, praktikën e shëndosha në tërësi, njohuritë profesionale dhe trajnimet.

Për më tepër, projekti do të synojë grupet e marginalizuara, siç janë gratë që janë kreu i familjeve të tyre, pakicave dhe personave me aftësi të kufizuara. Përsa i përket bashkëpunimit, projekti ka për qëllim krijimin e partneriteteve midis agrobizneseve, prodhuesve dhe përpunuesve fillestarë. Projekti do të nxisë adresimin e problemeve dhe nevojave të përbashkëta në bashkëpunim dhe partneritet të gjerë. Gjatë periudhës Shtator-Dhjetor 2018 janë nënshkruar marrëveshjet e bashkëpunimit me pesë komunat e përfshira me projekt, janë mbajtur seancat informative mbi aktivitetet e projektit, si dhe ka filluar përzgjedhja e përfituesve. Vitet e ardhshme dinamika e projektit do të rritet përmes përzgjedhjes, furnizimit, trajnimeve dhe monitimeve të rregullta. Andaj IADK përmes këtij projekti do të bëjë përpjekje për ri-integrimin e të kthyrëve në shoqëri, krijimin e kushteve në zonat rurale për tu marrë me ndonjë aktivitet bujqësor sado të vogël për t'i përkrahur, motivuar dhe angazhuar në mënyrë që të gjenerojnë të ardhura për jetesë në vendlindjen e tyre.

6. NGRITJA E KAPACITETEVE PROFESIONALE TË TË RINJËVE NË SEKTORIN E BUJQËSISË

IADK në vitin 2018 ka filluar zbatimin e projektit **“Ngritja e kapaciteteve profesionale të të rinjve në sektorin e bujqësisë”**, i cili është financuar nga projekti ‘Përkrahja e Luksemburgut për Shoqërinë Civile në Kosovë’, financuar nga Qeveria e Dukatit të Madh të Luksemburgut dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF). Projekti do të zbatohet gjatë dy viteve (2018/2019) dhe përfshinë 10 komuna: Drenas, Gjilan, Kamenicë, Viti, Podujevë, Mitrovicë, Rahovec, Pejë, Istog dhe Zubin Potok. Qëllimi i projektit është rritja e mundësisë për angazhimin e të rinjve në tregun e punës përmes ngritjes së kapaciteteve të tyre profesionale. Duke ngritur njohuritë profesionale në aspektin teorik e sidomos në atë praktik, të rinjtë do të kenë mundësi më të mëdha për t’u inkuadruar në tregun e punës apo për të shfrytëzuar dijen e tyre për vet-punësim në fermën e tyre.

Në fokus të projektit janë dy grupe të të rinjve:

- të rinjtë e zonave rurale të cilët nuk kanë mundur të vijnë shkollimin e lartë, e që merren apo kanë potencial për tu marrë me aktivitete bujqësore, dhe
- të rinjtë që kanë përfunduar apo janë në përfundim të shkollimit të lartë në fushën e bujqësisë apo teknologjisë ushqimore.

Grupi i parë trajnohet për praktikën më të mira për prodhimin dhe përpunimin e prodhimeve bujqësore, ndërsa grupit të dytë do t’i mundësohet kryerja e punës praktike.

Gjatë vitit 2018 janë zbatuar aktivitetet e projektit në komunat: Drenas, Viti, Podujevë, Mitrovicë, Istog, ndërsa në vitin 2019 do të zbatohen aktivitetet e projektit në komunat tjera.

6.1 Trajnimi i të rinjve në sektorin e bujqësisë/përpunimit

Në kuadër të këtij aktiviteti janë mbajtur trajnime me 16 grupe të rinjve me gjithsej 160 të rinjë, të cilët në varësi të vet përcaktimit tyre kanë përcjellur trajnimet në fushën e prodhimtarisë bujqësore apo në atë të përpunimit këtyre prodhimeve. Trajnimi i të rinjve është bërë në formë grupore, dhe në 8 sektorë të ndryshëm janë trajnuar nga dy grupe të të rinjve, e që janë detajuar në tabelën e mëposhtme:

Tabela e mbajtjes së trajnimeve me të rinjtë - ndarja sipas sektorëve dhe komunave					
Trajnimet sipas sektorëve	Nr. i grupit dhe komuna				
	Drenas	Viti	Podujevë	Mitrovicë	Istog
Perimtari			I	II	
Pemëtari	I			II	
Blegtori	I	II			
Bimë mjekësore	I				II
Përpunim i perimeve		I	II		
Përpunim i pemëve			I		II
Përpunim i qumështit	I				II
Përgatitja e ushqimit tradicional		I		II	

Tabela 3: Plani i mbajtjes së trajnimeve me grupe të të rinjve

Të rinjtë e përfshirë në trajnimet profesionale në sektorët e prodhimtarisë bujqësore kryesisht jetojnë në zona rurale, dhe kanë pasur njohuri të pjsërishme për veprimtaritë bujqësore me të cilat merren familjarët e tyre. Gjatë mbajtjes së trajnimeve teorike dhe praktike, si dhe vizitave për shkëmbim përvojash në ferma më të avancuara në Kosovë, të rinjtë kanë ndërruar pikpamjet dhe interesimin shumë të vogël që kanë pasur për sektorin e bujqësisë. Programet trajnuese për të rinjtë me shkollim të ulët në sektorët e prodhimtarisë bujqësore kanë përfshirë nga 5 ditë tema teorike profesionale në sektorin përkatës, 3 ditë demonstrime praktike në teren, 2 ditë trajnime në aspekti ekonomik, dhe 1 ditë vizitë studimore për përfitim të përvojave nga ferma më të avancuara në Kosovë.



Figura 27: Trajnim praktik për kultivimin e mjedrrave ~ grupi i të rinjve nga Drenasi

Ndërsa të rinjtë e trajnuar në sektorët e përpunimit të prodhimeve bujqësore kanë përcjellur 7 ditë trajnime teorike dhe praktike për përpunim, 2 ditë trajnime në aspekti ekonomik, dhe 1 ditë vizitë studimore për përfitim të përvojave në fushat përkatëse të përpunimit.

Përmes këtyre trajnimeve të rinjtë kanë përfutur njohuri për praktikën më të mira të kultivimit të pemëve, perimeve, bimëve mjekësore, për prodhimin e fidanëve, përgatitjen e tokës për mbjellje, mënyrat e mbjelljes, plehrimin dhe riplehrimin, masat e përkujdesit gjatë vegjetacionit, krasitjen dhe menaxhimin e sëmundjeve dhe dëmtuesve, vjeljen, trajtimin pas vjeljes, deponimin dhe ruajtjen. Derisa në sektorin e blegtorisë të rinjtë përmes trajnimeve teorike dhe demonstrimeve praktike në teren kanë mësuar për përgatitjen e ushqimeve cilësore për bagëtitë, për kohën dhe mënyrën e kositjes, tharjes dhe deponimit të ushqimeve voluminoze, duke ruajtur vlerat ushqyese të tyre, pastaj për llojet dhe raportet e përzierjes së dritharave të ndryshme për përgatitjen e ushqimeve të koncentruara, për kujdesin që duhet pasur në balancimin e materjeve energjetike dhe proteinike gjatë përgatitjes së racioneve ushqyese për kafshët në varësi të llojit, kategorisë dhe fazës në të cilën gjenden ato. Në aspektin e menaxhimit të higjienës në stalla, të rinjtë janë udhëzuar që të kenë vëmendjen më të lartë në mbajtjen e pastërtisë në stalla, mënyrën e përdorimit të makinës mjelëse dhe pstrimin e saj para dhe pas kryerjes së procesit të mjeljes, mënyrën e bartjes dhe deponimit të qumështit, mbajtjen në nivelin maksimal të higjienës në bidonat dhe laktofrizat ku vendoset dhe ruhet qumështi. Në sektorët e përpunimit të perimeve, pemëve, qumështit dhe për përgatitjen e ushqimit tradicional, po ashtu të rinjtë kryesisht të gjinisë femrore, janë aftësuar për proceset teknologjike të përpunimit dhe konservimit të prodhimeve të ndryshme bujqësore, me fokus të veçantë në metodat e përpunimit shtëpiak të këtyre prodhimeve, si dhe për gatimet e ushqimeve të ndryshme tradicionale. Të gjithë të rinjtë që kanë përcjellur trajnimet në sektorët përkatës të bujqësisë apo përpunimit, pas përfundimit të programeve trajnuese janë furnizuar edhe me disa pajisje esenciale për punë, që kanë një vlerë simbolike, por ju ndihmojnë gjatë punës në aktivitete bujqësore që do të kryejnë, si dhe janë pajisur me certifikata, që do të shërbejnë si dëshmi për aftësimin profesional në fushat përkatëse.



Figura 28: Vizitë studimore në Istog me grupet e të rinjve nga Drenasi dhe Mitrovica



Figura 29: Trajnim praktik për përpunim të pemëve me grupin nga Istogu

6.2 Përkrahje e studentëve në punë praktike

Në këtë aktivitet janë përkrahur 15 të rinjë/student të drejtimit të bujqësisë apo teknologjisë ushqimore për kryerje të punës praktike në kompani apo institucione të ndryshme që përkojnë me profilin e shkollimit të tyre. Këta të rinjë gjatë studimeve kanë mësuar më tepër në aspektin teorik, ndërsa ju ka munguar përvoja praktike si në aspektin e prodhimit apo përpunimit të produkteve, ashtu edhe shprehja dhe mënyra e sjelljes në punë.

Gjatë punës praktike në periudhë tre mujore ata kanë pasur rastin të përfitojnë përvoja të mira në aspektin profesional dhe administrativ, derisa njëri prej tyre është punësuar në kompaninë ku ka kryer praktikën, ndërsa njëri nga studentët është motivuar për të filluar kultivimin organik të bimëve mjekësore.

Të 15 të rinjtë/studentët e sistemuar në punë praktike në kompani/institucione përkatëse kanë vijuar dhe respektuar kohën e punës, kanë bërë shprehje të mirë të punës dhe kanë dorëzuar raportet mujore për aktivitetet me të cilat janë marrë gjatë ditëve të punës, derisa pas dorëzimit të raporteve IADK ka kryer pagesat mujore në vlerë prej 200 €, për mbulim të shpenzimeve të transportit, ushqimit dhe komunikimit, siç është paraparë me projekt.



Figura 27: Trajnim praktik për kultivimin e mjedrrave - grupi i të rinjve nga Drenasi

7. PROMOVIMI I MSA DHE RËNDËSISË SË EKSPORTIT TË PRODUKTEVE BUJQËSORE

Projekti **"Promovimi i MSA dhe rëndësisë së eksportit të produkteve bujqësore"**, është financuar nga Agjensioni Suedez për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar (Sida), menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF). Projekt 1 vjeçar i cili ka filluar me 01 Janar 2018 dhe përfunduar më 31 Dhjetor 2018, i cili kishte për synim të ngrisë kapacitetet e bizneseve në bujqësi përmes promovimit të MSA-së në eksportin e produkteve bujqësore në tregun e Bashkimit Evropian. Aktivitetet e projektit janë realizuar në të gjitha Regjionet e Kosovës.

Objektivi i përgjithshëm i projektit ishte lehtësimi dhe sqarimi i praktikave të MSA, që të ngritet numri i prodhuesve bujqësor që eksportojnë produkte në tregun e Bashkimit Evropian, ndërsa Objektivi specifik ishte ngritja e kapaciteteve të akterëve kryesorë në sektorin e bujqësisë dhe transmetimit sa më të mirë për të dhënë kontributin ndaj zbatimit të MSA-së.

7.1 Sesionet informuese

Fillimisht IADK ka organizuar sesione informuese në 7 regjione ku morën pjesë 212 pjesëmarrës nga të gjitha komunat duke përfshirë këtu edhe zyrtarët e komunave. Në këto sesione pjesëmarrësit janë informuar lidhur me projektin, përkatësisht me qëllimin e projektit dhe ndikimin e tij.

7.2 Hulumtim i përfituesëve potencial të MSA

Me qëllim të identifikimit të sektorëve me potencial të lartë për zhvillim të eksportit në tregun e Bashkimit Evropian, si dhe identifikimin e bizneseve të cilat i përmbushin kriteret për eksport, por nuk i kanë të qarta rregullat e MSA-së që produktet e tyre të eksportohen në shtetet e Bashkimit Evropian është zhvilluar një hulumtim për të marrë opinione nga bizneset për MSA-në. Në kuadër të këtij aktiviteti është përgatitur pyetësori me pyetje specifike për bujqësinë, eksportin dhe MSA-në, në mënyrë që të merren të dhëna sa më specifike nga të anketuarit. Anketat kanë përfshirë informatat e përgjithshme të biznesit, prodhimtarinë e tyre, planet e tyre dhe tregun që mbulojnë. Në total 36 kompani në 7 Regjionet e Kosovës janë anketuar dhe pas analizës së këtyre të dhënave është publikuar raporti me konkludime dhe rekomandime, të cilat janë përdorur si udhëzues gjatë trajnimeve, organizimit të punëtorive dhe konferencës. Raporti në fillim është publikuar në 1000 kopje (700 në gjuhën shqipe, 200 në gjuhën serbe dhe 100 në gjuhën angleze). Për shkak të interesimit për raportin janë shtypur edhe 100 kopje shtesë të këtij raporti në gjuhën angleze.



Figura 28: Broshura - Raporti i hulumtimit

7.3 Trajnimet

Pas përfundimit të hulumtimit dhe marrjes së informacioneve nga bizneset që eksportojnë dhe atyre që kanë potencial për të eksportuar produkte bujqësore në tregun evropian, IADK ka filluar me organizimin dhe mbajtjen e trajnimeve në të 7 Regjionet e Kosovës. Ashtu si ishte paraparë edhe në projekt, fillimisht janë mbajtur 10 ditë trajnime, por më pastaj me kërkesë të tri komunave tjera (Suharekë, Skenderaj dhe Podujevë) janë organizuar edhe 3 ditë trajnime shtesë në këto komuna. Në këto trajnime gjithsej 158 pjesëmarrës kanë marrë informacione për rëndësinë e MSA-së në bujqësi, benefitet e kësaj marrëveshje dhe lehtësitat që i hasin. Gjatë zbatimit të saj. Po ashtu për lehtësim të punës së tyre është shpjeguar përdorimi i tarifave të integruara të Kosovës dhe janë njoftuar me faqen e internetit të BE-së <http://trade.ec.europa.eu> ku mund t'i marrin të gjitha specifikat për produkte të kërkuara nga të gjitha shtetet e BE-së.

7.4 Vizitë studimore

Një aktivitet tjetër i rëndësishëm të cilin e ka organizuar IADK, është edhe vizita dy ditore në Mal të Zi, e mbajtur më datë 02 dhe 03 Korrik 2018. Kjo vizitë kishte për qëllim të merren përvojat e praktikimit të rregullave të MSA-së në këtë shtet. Në vizitë ishin gjithsej 8 pjesëmarrës nga palët kryesore të interesit. Për organizim të vizitës është kontaktuar një partner i IADK-së në Mal të Zi, i cili ka përgatitur një agjendë shumë të mirë të vizitës, me ç'rast janë vizituar palët e ndryshme siç janë: fermer/biznese të ndryshme, organizata të ndryshme, pastaj me përfaqësuesen e odes ekonomike e cila ka qenë akteri kyq në negociime në parlamentin e Malit të Zi, në procesin e negociimit të kapitullit të bujqësisë për MSA në mes të Malit të Zi dhe BE.



Figura 32: Vizita studimore në Mal të Zi

7.5 Punëtoritë

Me qëllim të ofrimit dhe shkëmbimit sa më të madhë të informacioneve për përparësitë dhe sfidat e hasura gjatë zbatimit të MSA-së, janë organizuar edhe 7 puntori nëpër regjione, ku kanë marrë pjesë gjithsej 130 pjesëmarrës. Në këto punëtori të udhëhequra nga stafi gjegjë i IADK-së, kanë marrë pjesë udhëheqës dhe përfaqësues të drejtorive për bujqësi nga komunat e 7 regjioneve, zyrtar nga Agjensioni i Ushqimit dhe Veterinarisë së Kosovës (AUVK), inspektor fitosanitar, zyrtar nga dogana, përfaqësues të Organizatave të Shoqërisë Civile (OSHC), përfaqësues të bizneseve bujqësore si dhe fermer. Gjatë punëtorive janë shtjelluar përparësitë e MSA-së, obligimet si dhe është diskutuar rreth sfidave me të cilat ballafaqohen fermerët dhe bizneset në punët e tyre, e të cilat janë të lidhura me MSA. Pas përfundimit të punëtorive janë përmbledhur të gjeturat dhe rekomandimet, të cilat më pastaj janë prezentuar gjatë konferencës.



Figura 33: Pamje nga puntoritë

7.6 Konferenca

Më datë 31 Tetor 2018 është mbajtur konferenca me temë: "MSA sfidat dhe problemet që ballafaqohen prodhuesit vendor". Konferenca është mbajtur në Hotelin Sirius në Prishtinë dhe kanë marrë pjesë 44 pjesëmarrës, nga palët e ndryshme të interesit, si janë: Zëvendës Ministri i MBPZHR, Zëvendës Ministri i MTI, Zëvendës Ministri i MF, Sekretari i përgjithshëm i MIE, Kryeshefi Ekzekutiv i AUVK, donator të ndryshëm, OSHC, fermer/eksportues, media. Në pjesën parë kanë marrë fjalën përfaqësuesit e institucioneve të cilët prezantuan punët e tyre nga perspektiva e MSA-së.

Pas fjalimeve është prezantuar video reportazhi dhe prezentimi i të gjeturave dhe rekomandimeve si dhe prezentimi i hulumtimit.

Në pjesën e dytë janë hapur diskutimet me panelistët dhe janë diskutuar shumë çështje që kanë të bëjnë me MSA-në, problemet, sfidat që janë duke i hasur eksportuesit.



Figura 34: Mbajtja e konferencës

7.7 Materialet e Vizibilitetit

Kanë promovuar projektin dhe donatorët e projektit në kohë reale në të gjitha aktivitetet që janë zbatuar. Në fillim të projektit është publikuar fletëpalosja informuese në 500 kopje dhe dy banera. Për të informuar fermerët, bizneset dhe të gjitha palët e interesit, për të promovuar eksportin e bujqësisë në shtetet e Bashkimit Europian, dhe për të vetëdijësuar për format dhe proceset se si të eksportohen produktet bujqësore është publikuar broshura me 10 faqe në të cilën janë të paraqitura format dhe procedurat për eksportimin e produkteve bujqësore.

7.8 Video reportazh

Për informimin e fermerëve dhe qytetarëve të Kosovës, si dhe shpjegimin e rolit të MSA në bujqësi, është xhiruar një video reportazh që ka paraqit kompanitë e suksesshme që eksportojnë në tregun Evropian. Reportazhi do të luaj një rol dhe jetë shembull në sensibilizimin e fermerëve dhe kompanive që veprojnë në bujqësi. Kete video mund ta gjeni ne you tube: <https://www.youtube.com/watch?v=5lelgqlxfnw&t=17s>

8. MONITORIMI I PROCESIT TË KONSULTIMEVE PUBLIKE NË NIVEL TË QEVERISË 2018

Gjatë vitit 2018 IADK është kontraktuar nga KCSF për kryerje të shërbimeve për monitorim apo hulumtim të transparencës së organeve qeveritare gjatë përgatitjes apo konsultimeve publike të dokumenteve të ndryshme.

Sipas kontrates është paraparë monitorimi i së paku 3 dokumenteve të ndryshme, si janë: Koncept dokumente, Strategji apo Projekt ligje, të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR).

Në kuadër të këtyre angazhimeve IADK ka monitoruar 2 dokumente të MBPZHR:

1. Koncept dokumenti për ndryshimin e politikave fiskale dhe bujqësore për prodhimin e duhanit dhe cigareve në Kosovë
2. Projekt ligjin për bujqësi dhe zhvillim rural

9. MBËSHTETJA E NDËRMARRËSISË SHOQËRORE DHE PROMOVIMI I FUQIZIMIT SOCIAL-EKONOMIK NË KOMUNITETET MINORITARE NË KOSOVË

Në fillim të muajit Maj IADK ka nënshkruar kontratë me Organizaten DRC (Këshilli Danez për Refugjat) për implementimin e komponentes në sektorin e bujqësisë, në kuadër të projektit të DRC “Mbështetja e Ndërmarrësisë Shoqërore dhe Promovimi i Fuqizimit Social-ekonomik në Komunitetet Minoritare në Kosovë” dhe financuar nga SIDA.

IADK si sub grantist do të zbatojë aktivitetet në mbështetje të arritjes së rezultatit në vijim:

Individët nga grupet më të marginalizuara të minoriteteve në Zveçan dhe Mitrovicën e Veriut, janë fuqizuar në mënyrë shoqërore dhe ekonomike, përmes mbështetjes së ofruar për prodhuesit, përpunuesit dhe tregtarët e me pakicë, si dhe krijimi i lidhjeve me tregjet më të gjera të popullsisë shumicë.

Projekti do të zgjasë deri më 31 dhjetor 2021, dhe është më shumë i fokusuar te përkrahja e fshatrave me popullësi shqiptare, por edhe në bashkëpunimin me komunitetin serb.

Gjatë vitit 2018 është paraparë të realizohet ky aktivitet:

Kryerja e vlerësimit të tregut të shënjestruar të zonave rurale dhe bujqësore në Mitrovicën e Veriut dhe në Zveçan, me një fokus të veçantë në të kthyerit dhe nevojat e grave.

9.1 Faza përgatitore

Gjatë kësaj faze të zbatimit të projektit janë nënshkruar 3 memorandume mirëkuptimi në mes të IADK-së dhe palëve të interesit, si janë:

1. Memorandum Mirëkuptimi në mes të IADK-së dhe Komunës së Zveçanit;
2. Memorandum Mirëkuptimi në mes të IADK-së dhe Komunës së Mitrovicës së Veriut, dhe
3. Memorandum Mirëkuptimit në mes të IADK-së dhe Agjencisë Kadastrale të Kosovës;



Figura 35: Nënshkrimi i MeM me Agjencinë Kadastrale të Kosovës

Në bazë të MeM të tria palët kanë caktuar nga një kordinator për bashkëpunim gjatë zbatimit të projektit, dhe së bashku janë përpiluar listat e të intervistuarve, ku janë përfshirë të gjitha palët e interesit, përfaqesuesit e institucioneve lokale, qendra e biznesit e Zveçanit, fermer, përfaqesues të fshatrave. Po ashtu IADK ka përgatitur formën e pyetësorit, i cili është përdorur për intervistim.

9.2 Zbatimi i aktivitetit

Së bashku me koordinatoret e të dy komunave (Zveçanit dhe Mitrovicës së Veriut) janë realizuar 15 intervista në Zveçan dhe 14 intervista në Mitrovicën e Veriut, edhe pse janë planifikuar vetëm 5 intervistat për secilën komunë.

Në bazë të këtyre intervistave si të dhëna primare dhe në bazë të dhënave sekondare, raporteve të ndryshme të prodhuara nga organizata dhe institucione të ndryshme, janë përgatitur 2 raporte të vlerësimit të tregut të shënjestruar të zonave rurale dhe bujqësore në Mitrovicën e Veriut dhe në Zveçan, me një fokus të veçantë në të kthyerit dhe nevojat e grave.



Figura 36: Realizimi i intervistës

10. BASHKËPUNIMIT NË MES TË ETNITETEVE TË GRAVE NË KOMUNËN E VUSHTRRISË

Ky projekt është përkrahur nga Community Development Fund – CDF në kuadër të projektit “Avancojmë Kosovën së Bashku – Zgjidhje Vendore”. Projekti është zbatuar në periudhën 3 mujore (Maj – Korrik 2018) në bashkëpunim me Grupin jo Formal të Grave të Komunës së Vushtrrisë.

Qëllimi i përgjithshëm i projektit është rritja dhe forcimi i bashkëpunimit mes grave shumicë kosovare dhe grave minoritare në Vushtri, me qëllim shkëmbimin e njohurive dhe rritjen e aktivitetit të tyre ekonomik përmes trajnimeve profesionale në përpunimin e ushqimit. Projekti përkrahu grupet e grave që ishin të papuna, në kushte të vështira ekonomike, në zonat rurale dhe të cilat janë të gatshme të punojnë dhe të shoqërohen me të tjerët. Tri grupe grash u formuan për të përcjellur trajnimet në tri module të përpunimit: Moduli i Qumështit, Moduli i Brumërave dhe Moduli i Pemëve dhe Perimeve. Çdo grup kishte gjithsej 12 pjesëmarrëse, përfshirë edhe gra të pakicave serbe.

Gjithsej 36 gra morën pjesë në 7 trajnime profesionale në secilin modul, gjithsej 11 gra të pakicave serbe ndoqën trajnimet. Në këto 7 seanca trajnimi, ekspertet e IADK-së i përshtatën temat për secilin grup dhe ofruan trajnime që përfshijnë teorinë dhe konceptet themelore të përpunimit, trajnimet praktike dhe demonstrative në përpunimin e produkteve të ndryshme. Pastaj trajnimet menaxheriale se si të zhvillojnë aktivitetet e tyre dhe të marrin masa për krijimin e aktiviteteve biznesore. Temat e trajnimit profesional në sektorin e përpunimit përfshinin tema të tilla si: higjiena personale dhe mjeteve të punës, standardizimi i produkteve, siguria ushqimore, përgatitja e preparateve, përgatitja e turshive, përpunimi i qumështit në produkte të ndryshme dhe përgatitja e ushqimeve tradicionale më të njohura të kërkuara në treg.

Pas mbarimit të trajnimeve me secilin grup janë organizuar vizita një ditore në Kosovë, me qëllim të marrjes së përvojave nga gratë tjera që merren me aktivitete të ngjashme biznesore. Përveç përvetësimit të njohurive, ky aktivitet ka ndikuar në socializimin e grave të etnive të ndryshme, të lidhin marrëdhënie për të bashkëpunuar me njëra - tjetrën, si dhe për të fituar njohuri dhe motivim për punë, duke vizituar gratë e suksesshme në pjesë të ndryshme të Kosovës.

Një aktivitet tjetër i rëndësishëm në kuadër të këtij projekti ishte edhe organizimi i panairit për ekspozim të produkteve të ndryshme. Panairi u organizua në Sheshin e Vushtrrisë, ku 21 gra ndërmarrëse në fushën e përpunimit të prodhimeve bujqësore kanë ekspozuar produktet e tyre. Gratë që promovuan produktet e tyre ishin gratë që morën pjesë në trajnime profesionale dhe gra të tjera të interesuara që kishin gatishmërinë për të promovuar prodhimet e tyre. Gratë ekspozuan produktet e tyre në panair gjatë dy ditëve dhe shitën produkte e tyre, me një vlerë totale prej 1,227 €. Ato ishin të lumtura për të ndarë njohuritë e tyre për përgatitjen tradicionale të ushqimit dhe përpunimin e pemëve dhe perimeve. IADK ka shpërndarë edhe certifikatat për aftësim profesional të këtyre grave, si dëshmi për kryerjen e trajnimeve në fushat përkatëse.



Figura 37: Trajnimi praktik me grupin e grave



Figura 38: Pamje nga ekspozimi i produkteve në panair



Figura 39: Certifikimi i grave të trajnuara

11. MBËSHTETJA E PËRPUNUESVE TË USHQIMIT NË KOMUNAT- PRISHTINË, NOVOBËRDË, KAMENICË DHE RANILLUG

IADK është kontraktuar nga CARE për ofrimin e shërbimeve këshillimore për disa përfitues në Komunën e Prishtinës, Novobërdës, Kamenicës dhe Ranillug, të cilët i ka përkrahur përmes projektit RESI, me grante investuese në sektorin e përpunimit dhe ruajtjes së prodhimeve. Qëllimi i këtyre shërbimeve ishte të mbështesë këta përfitues, sidomos përpunuesit agrourbues të njihen me kërkesat kryesore të zbatimit GMP / HACCP, kërkesat për standardet e sigurisë së ushqimit dhe higjienës, teknologjisë së përpunimit dhe teknologjisë së prodhimit të uthulles. Konkretisht qëllimi ishte të këshillohen, të fitojnë njohuri praktike lidhur me higjienën personale, higjienën e objektit dhe pajisjeve, menaxhimin e prodhimit të ushqimit, pasterizimin teknik dhe përpunimit të xhemit, ajvarit, turshive etj.

Të gjithë përfituesit e vizituar janë njohur me standardet si GMP / HACCP, dhe rëndësinë e aplikimit të tyre (pasi që shumica e përfituesve janë biznese të reja), pastaj udhëzime dhe këshilla për sigurinë e ushqimit dhe teknologjinë e prodhimit, konservimin e pemëve dhe perimeve, dhe teknologjinë e përpunimit të prodhimeve blegtorale, teknika dhe receptura të ndryshme për përpunimin e pemëve dhe perimeve.



Figura 40: Pamje nga vizita me përfituesit në njësin e përpunimit në Malishevë

PUBLIKIMET LISTA E FLETËPALOSJEVE TË PUBLIKUARA

Nr.	Titulli i publikimit	Sektori	Donatori
1	"Ngritja e kapaciteteve profesionale të rinjëve në sektorin e bujqësisë"	Hortikultura	KCSF - Y
2	"Njësia për përgatitjen e ëmbëlsirave", Shtime	Përpunim	BfdW
3	"Njësia përpunuese e pemëve dhe perimeve", Ferizaj	Përpunim	BfdW
4	Bufeja në SHF "Emin Duraku", Shtime	Përpunim	BfdW
5	"Promovimi i MSA dhe rëndësisë së eksportit të produkteve bujqësore"	Përpunim	KCSF - MSA
6	"Mbështetja e zinxhirit të vlerave të BMA përmes krijimit të punësimit dhe vazhdimit të eksportit"	Hortikulturë	GIZ - MAP
7	"Përkrahja e 105 përfituesëve me grante"	Bujqësi	GIZ - R
8	"Njësia për përgatitjen e ëmbëlsirave", Shtime	Përpunim	BfdW 1
9	"Njësia përpunuese e pemëve dhe perimeve", Mitrovicë	Përpunim	BfdW 1
10	"Njësia përpunuese e pemëve dhe perimeve", Zubin Potok	Përpunim	BfdW 1

LISTA E BROSHURAVE TË PUBLIKUARA

Nr.	Titulli i publikimit	Sektori	Donatori
1	Raport hulumtimi "Promovimi i MSA dhe rëndësisë së eksportit të produkteve bujqësore"	Përpunim	KCSF - MSA
2	Udhëzues për format dhe proceset e eksportimit të produkteve bujqësore	Përpunim	KCSF - MSA
3	Raporti vjetor 2018 - IADK	-	Gjithë

VIZITAT E STAFIT DHE VIZITAT ME FERMERË GJATË VITIT 2018

Nr.	Vendi	Datat	Nr. i ditëve	Nr. i pjesëmarrësve	Sektori
1	Gjermani	16-23.01.2018	7	1	Menaxhment
2	Kroaci	06-07.12.2018	2	2	Menaxhment
3	Novi Sad	15-16.05.2018	2	38	Përgjithshme
4	Mali i Zi	02-03.07.2018	2	7	Përgjithshme
5	Kosovë	11.05.2018	1	16	Blegtori
6	Kosovë	20.06.2018	1	19	Pemëtar
7	Kosovë	13.07.2018	1	13	Perimtar
8	Kosovë	04.09.2018	1	24	Përpunim i perimeve
9	Kosovë	15.08.2018	1	19	Bimë mjekësore
10	Kosovë	08.11.2018	1	20	Përpunim i pemëve
11	Kosovë	17.10.2018	1	17	Pergat. e ushqimit tradicional
12	Kosovë	04.12.2018	1	20	Përpunim i qumështit
13	Kosovë	14.08.2018	1	27	Përpunim
14	Kosovë	11.07.2018	1	13	Përpunim i pemëve/perimeve
15	Kosovë	12.07.2018	1	14	Përpunim i ushqimit
16	Kosovë	13.07.2018	1	14	Përpunim i qumështit
17	Kosovë	28.09.2018	1	15	Pemëtar
18	Kosovë	09.10.2018	1	13	Blegtori
19	Kosovë	30.10.2018	1	49	Përpunim
20	Kosovë	15.11.2018	1	12	Praktikantët-studentët
Total			29	353	


LISTA E STAFIT TË IADK-SË PËR VITIN 2018

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Titulli i vendit të punës
1	ZENEL BUNJAKU	Drejtor Ekzekutiv
2	ESMA AZEMI KËPUZI	Udhëheqëse e departamentit të Financave, Logjistikës & Administratës
3	ARIANA SELMANI PECI	Zyrtare për Prokurim & Administratë
4	ELHEME SHALA	Asistente e Financave
5	PETRIT KOCI	Mirëmbajtës i rrjetit/sistemit
6	SYLEJMAN BUNJAKU	Udhëheqës i departamentit të Hortikulturës
7	SKENDER FEJZULLAHU	Inxhinier i Bujqësisë – Pemëtar (deri më 30.04.2018)
8	SHERIF MEHMETI	Inxhinier i Bujqësisë - Pemëtar
9	NOVICA MARKOVIC	Inxhinier i Bujqësisë
10	MAGBULE HYSINI	Udhëheqëse e departamentit të përpunimit të ushqimit
11	HAFIZE VESELI SYLEJMANI	Inxhinier e Përpunimit të ushqimit
12	HANUMSHAHE ZENELI	Asistente e Përpunimit të ushqimit
13	FIDAN SKERAJ	Udhëheqës i Departamentit të Blegtorisë
14	ARBËR HASANI	Asistent i Blegtorisë
15	SHKURTE BUNJAKU	Asistente e Projektit
16	EGZON GERXHALLIU	Projekt Menaxher
17	EGZONA HAJRA	Asistente e Projektit
18	ARGJEND GJINOVCI	Asistent i Projektit
19	ARTA IBRANI ZHUBI	Menaxhere e Projektit
20	FEHMI BASHOLLI	Kujdestar i objektit
21	SHPRESA MUSA	Praktikante
22	ALBINA AHMETAJ	Praktikante
23	ARBONITA ABAZAJ	Praktikante

TË HYRAT E IADK-SË NGA DONATORËT PËR VITIN 2018

	Emri i Donatorit/Partnerit	Emri i Projektit	Shuma €	Përqindja %
1	Bread for the World	Mbështetja e fermerëve të vegjël me pajisje dhe promovimin e energjisë së ripërtrishme	175,373	25.70%
	Fermerët		20,109	3.00%
2	Bread for the World	Mundësimi i vetëpunësimit të rinjve dhe grupeve të marginalizuara në zonat rurale në Kosovë	151,290	22.20%
	Komunat (Shtime, Ferizaj, Vushtrri, Mitrovicë, Skenderaj) and Farmers		34,054	5.00%
3	Shoqëria Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ) GmbH	Mbështetja e zinxhirit të vlerave të MHAP përmes krijimit të punësimit dhe vazhdimet të eksportit	127,066	18.60%
	Fermerët		25,086	3.70%
4	Fondacionit Kosovor për Shoqëri Civile (KCSF)	Ndërtimi i kapaciteteve profesionale të rinjve në sektorin e bujqësisë	69,970	10.30%
5	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP)	Mbështetja e fuqizimit ekonomik të fermerëve të vegjël në komunat veriore të Regionit të Mitrovicës	31,370	4.60%
6	Shoqëria Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ) GmbH	Përfshirja ekonomike e të kthyerve përmes bujqësisë në zonat rurale dhe ngritja e kapaciteteve përmes formimit profesional	18,088	2.70%
7	Fondacionit Kosovor për Shoqëri Civile (KCSF)	Promovimi i MSA dhe Rëndësia e Eksportit të Produkteve Bujqësore	19,559	2.90%
8	Fondi i Zhvillimit të Komunitetit (CDF)	"Krijimi i bashkëpunimit në mes të etniteteve të grave në komunën e Vushtrrisë"	5,000	0.70%
9	Këshilli Danez për Refugjatët (DRC)	Mbështetja e Ndërmarrësisë Shoqërore dhe Promovimi i Fuqizimit Social-ekonomik në Komunitetet Minoritare në Kosovë	4,557	0.70%
	Gjithësej		681,522	100%


Koment: Të gjitha të hyrat e paraqitura janë të hyra që janë njohur gjatë vitit 2018, përfshirë edhe të hyrat e shtyera



TË HYRAT E IADK-SË NGA PARTNERËT PËR VITIN 2018

	Emri i Partnerit	Emri i Projektit	Shuma €	Përqindja %
1	Komuna e Shtimes	Shërbimet Këshillimore dhe Trajnime për fermerë	1,716	16.40%
2	Komuna e Ferizajit	Shërbimet Këshillimore dhe Trajnime për fermerë	1,608	15.30%
3	Komuna e Vushtrrisë	Shërbimet Këshillimore dhe Trajnime për fermerë	840	8.00%
4	Komuna e Skenderajt	Shërbimet Këshillimore dhe Trajnime për fermerë	960	9.20%
5	Komuna e Mitrovicës	Shërbimet Këshillimore dhe Trajnime për fermerë	1,080	10.30%
6	Care International	Trajnime dhe vizita për fermerë	1,680	16.00%
7	Yuniko	Intership	990	9.40%
8	AFDI	Organizimi I vizitës studimore	772	7.40%
9	KCSF	Rrjetëzim	324	3.10%
10	Caritas	Trajnime në Blegtori	277	2.60%
11	CNVP	Trajnime për OJQ	127	1.20%
12	SHG/WA ZGJIMI	Kontabilitet për OJQ	114	1.10%
	Gjithësej		10,488	100%

Koment: Të gjitha të hyrat e paraqitura janë të hyra që janë njohur gjatë vitit 2018





Adresa:

Sfaraçak i Ulët, Nr.11,
42000 Vushtrri,
Kosovë

E-mail: info@iadc.org
Tel: +383 (0) 44 777 036
+383 (0) 49 777 046
Web: www.iadc.org